



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 6568 prot.

Data: 21, 5, 2024

VENDIM
Nr. 6568, Datë 21, 5, 2024

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

- 1. Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Profesionale "Charles Telford Erikson", Golem, Kavajë.
- 2. Akti zyrtar i themelimit/licencimit:** Urdhër nr. 490, datë 27.12.2005, protokolluar me nr. 8936 prot., i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për dhënien e statusit "shkolla të nivelit kombëtar" disa shkollave të mesme teknike, profesionale dhe social-kulturore",
- 3. Organizimi i institucionit:** Shkollë e mesme profesionale publike
- 4. Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë e mesme profesionale
- 5. Nipti:** K63312801J

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

konstatoj se:

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

1. Akreditimin me kusht për kualifikimet profesionale:
 - a) "Bujqësi", Niveli II në KSHK, Kodi H-II-22
 - b) "Agroturizëm", Niveli III në KSHK, Kodi H8-III-18
 - c) "Bujqësi", Niveli IV në KSHK, Kodi H-IV-20
 - d) "Ekonomi – Biznes", Niveli II në KSHK, L-II-21
 - e) "Llogari", Niveli IV në KSHK, L4-IV-19
 - f) "Veterinari", Niveli IV në KSHK, N-IV-21
2. Afati përfundimtar i akreditimit me kusht është 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Në përputhje me propozimin përkatës nr. 185/8, datë 08.11.2023 ardhur nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):
3. Ofruesi i AFP-së të plotësojë rekomandimet e paraqitura në propozimin përkatës nr. 185/8, datë 08.11.2023, ardhur nga AKAFPK-ja, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
4. Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

